

### Përmbledhje

Në gjysmën e parë të vitit 2019, Ekonomia e Kosovës vlerësohet se ka shënuar përsheptim të rritjes së aktivitetit ekonomik. BPV-ja reale në TM1 2019 shënoi rritje vjetore prej 4.1 përqind, ndërkohë, si rezultat i zhvillimeve pozitive në sektorin e jashtëm si dhe rritjes së konsumit publik, aktiviteti ekonomik gjatë TM2 2019 vlerësohet të jetë karakterizuar me rritje më të lartë. Rritja e aktivitetit ekonomik, ndër të tjera ka ndikuar edhe në rritjen e të hyrave buxhetore, ndërkohë që shpenzimet buxhetore u karakterizuan me rritje të ngadalësuar.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019, sistemi financiar u karakterizua me rritje të aseteve të përgjithshme për 153.3 milionë euro, rritje e cila i atribuohet kryesisht rritjes së aseteve të sektorit bankar dhe atij pensional. Kreditimi, si kontribuuesi kryesor në rritjen e aseteve të sektorit bankar, vazhdoi trendin pozitiv të rritjes. Aktiviteti kreditues, vetëm gjatë tremujorit të dytë të këtij viti, ndikoi në zgjerimin e stokut të kredive për 115.9 milionë euro. Megjithatë, kjo vlerë ishte më e ulët se në tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, ndikuar kryesisht nga dinamikat në kreditë për ndërmarrjet.

Aktiviteti kreditues i sektorit kryesisht u mbështet nga rritja e përsheptuar e depozitave gjatë tremujorit të dytë, rritje e cila kryesisht i'u atribuua rritjes së normave të interesit, veçanërisht normave të aplikuara në depozitat e ekonomive familjare. Për dallim nga tremujorët e kaluar ku dominonin depozitat e transferueshme, në TM2 2019 depozitat e afatizuara dominuan strukturën e gjithsej depozitave të sektorit.

Performanca financiare e sektorit bankar gjatë këtij tremujori rezultoi të ketë qenë pozitive, megjithëse me një rritje marginale krahas periudhës së njëjtë të vitit të kaluar. Sektori bankar u karakterizua me rritje më të lartë të shpenzimeve të përgjithshme si pasojë e rritjes së shpenzimeve për provizione dhe për depozita, krahas rritjes

së të hyrave të sektorit si rezultat i rritjes së të hyrave nga interesi.

Cilësia e portofolit kreditor të sektorit bankar u përmirësua tutje, duke regjistruar nivelin më të ulët të kredive jo-performuese që nga gjysma e dytë e vitit 2010 prej 2.5 përqind, ndërkohë që shkalla e mbulueshmërisë së kredive jo-performuese me provizione qëndroi në nivel të kënaqshëm prej 161.2 përqind. Gjithashtu, Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit prej 16.8 përqind dhe niveli i likuiditetit, shprehur përmes raportit të aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra prej 35.1 përqind, sugjerojnë për qëndrueshmërinë e sektorit.

Sektori pensional vazhdon të zgjerohet, duke u mbështetur si në kthimin pozitiv nga investimet ashtu edhe në kontributet e arkëtuara në periudhën raportuese.

Gjatë tremujorit të dytë, sektori i sigurimeve shënoi rritje të aktivitetit. Megjithatë, përkundër rritjes së primeve të shkruara, rritja e shpenzimeve operative dhe kompensimeve për dëmet e paguara u përkthye në rezultate negative financiare.

Sektori mikrofinanciar shfaq shenja të ngadalësimit të aktivitetit gjatë TM2 2019, periudhë gjatë së cilës u karakterizua me ngadalësim të rritjes së aktivitetit kreditues, ulje të profitit të realizuar si dhe rritje të kredive me probleme.

Në TM2 2019, Qeveria e Kosovës emetoi borxh në vlerë prej 110 milionë euro, në një ambient ku ofertat nga institucionet financiare tejkaluan shumën e kërkuar nga Ministria e Financave.

## PËRMBAJTJA

<b>Përmbledhje</b> .....	<b>-i</b>
<b>Zhvillimet Makroekonomike</b> .....	<b>-5</b>
<b>Sistemi Financiar</b> .....	<b>-6</b>
<b>Sektori Bankar</b> .....	<b>-6</b>
Asetet .....	-6
Performanca e sektorit bankar .....	12
<b>Sektori pensional</b> .....	<b>14</b>
<b>Sektori i sigurimeve</b> .....	<b>15</b>
Performanca e sektorit të sigurimeve .....	16
<b>Sektori mikrofinanciar</b> .....	<b>16</b>
Asetet .....	16
Performanca e sektorit mikrofinanciar .....	18
<b>Tregu i letrave me vlerë</b> .....	<b>20</b>

## GRAFIKËT DHE TABELAT

Figura 1. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës .....	06
Figura 2. Asetet e sektorëve përbërës të sistemit financiar .....	06
Figura 3. Struktura e aseteve të sektorit bankar në tremujorët përkatës .....	07
Figura 4. Ndryshimi vjetor i tremujorëve përkatës të kredive dhe kategorive kryesore të kredive .....	07
Figura 5. Kreditë aktive dhe të reja për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare .....	07
Figura 6. Struktura e kredive sipas veprimtarie ekonomike .....	08
Figura 7. Struktura e detyrimeve dhe detyrimeve vetanake .....	08
Figura 8. Vlera e gjithsej depozitave dhe kategorive kryesore gjatë TM2 .....	09
Figura 9. Struktura e depozitave gjatë periudhave raportuese .....	09
Figura 10. Norma e interesit në kredi dhe depozita .....	10
Figura 11. Norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve .....	10
Figura 12. Norma e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare .....	11
Figura 13. Norma e interesit në depozitat .....	11
Figura 14. Norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve .....	11
Figura 15. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare .....	11
Figura 16. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar .....	12

Figura 17. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve -----	12
Figura 18. Treguesit e solvencës -----	12
Figura 19. Treguesit e likuiditetit -----	12
Figura 20. Asetet e sektorit pensional -----	13
Figura 21. Struktura e asetëve të FKPK-së -----	14
Figura 22. Struktura e asetëve të FSKP-së -----	15
Figura 23. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së -----	15
Figura 24. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	15
Figura 25. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara -----	16
Figura 26. Asetet e sektorit mikrofinanciar -----	17
Figura 27. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve -----	17
Figura 28. Vlera e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve të ekonomisë -----	17
Figura 29. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar -----	18
Figura 30. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	18
Figura 31. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve të ekonomisë -----	18
Figura 32. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	19
Figura 33. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar -----	19
Figura 34. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore -----	19
Figura 35. Shuma e borxhit të emetuar -----	20
Figura 36. Shuma e ofruar dhe e emetuar -----	20
Figura 37. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë -----	20
Tabela 1. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	22

**SHKURTESAT:**

APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CHF	Franku Zvicërran
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik
IHD	Investimet Huaja Direkte
KJP	Kreditë Jopërfomuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
USD	Dollari Amerikan
WEO	World Economic Outlook

## Zhvillimet Makroekonomike

Sipas të dhënave preliminare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja reale në TM1 2019 shënoj rritje vjetore prej 4.1 përqind, rritje kjo e mbështetur kryesisht nga rritja e konsumit dhe investimeve ndërsa eksportet neto ndikuan negativisht. Meqenëse të dhënat zyrtare për TM2 2019 nuk janë publikuar ende, mbështetur në tregues tjerë me frekuencë më të lartë publikimi, rritja ekonomike gjatë këtij tremujori vlerësohet të ketë qenë më e lartë. Vlerësimet për një rritje më të lartë mbështeten në zhvillimet pozitive në sektorin e jashtëm (rritjes së përshpejtuar të eksportit të mallrave dhe shërbimeve, IHD-ve, remitencave, kompensimit të punëtorëve) si dhe rritjes së konsumit publik.

Niveli i çmimeve të konsumit deri në qershor 2019 është rritur për 3.1 përqind, kryesisht si pasojë e rritjes së çmimeve të ushqimit. Inflacioni bazë (që përjashton ushqimin, energjinë, pijet alkoolike dhe duhanin), shënoj rritje prej vetëm 0.4 përqind apo 2.7 pikë përqindje më ulët krahasuar me inflacionin e përgjithshëm.


Sektori fiskal deri në qershor 2019 u karakterizua me rritje të të hyrave prej 7.7 përqind dhe ngadalësim të rritjes së shpenzimeve buxhetore prej 2.9 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi suficit primar buxhetor prej 0.3 milionë euro (37.1 milionë euro deficit në periudhën e njëjtë të vitit 2018). Borxhi publik në TM2 2019 ka arritur në 1.13 miliardë euro, që është për 9.3 përqind më i lartë krahasuar me TM2 2018. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 16.5 përqind nga 16.3 përqind sa ishte në TM2 2018.

Deri në qershor 2019, sektori i jashtëm është karakterizuar me zvogëlim të deficitit të llogarisë rrjedhëse për 10.0 përqind. Zvogëlimi i deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet rritjes së bilanceve pozitive të shërbimeve, të ardhurave parësore dhe të ardhurave dytësore ndërsa deficitit i mallrave shënoj rritje. Në kuadër të bilancit të pagesave, remitencat dhe Investimet e Huaja Direkte (IHD) shënuan rritje vjetore prej 5.5 përqind përkatësisht 53.2 përqind.

## Sistemi Financiar

Vlera e gjithsej asetëve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 6.67 miliardë euro në fund të gjysmës së parë të vitit 2019, që përkon me një rritje vjetore prej 11.2 përqind (figura 1).


Figura 1. Vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës



Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur  
Burimi: BQK (2019)

Në baza tremujore, asetet e sistemit financiar u rritën për 153.3 milionë euro. Sektori bankar vazhdon të ketë kontributin kryesor në zgjerimin e aktivitetit të sistemit financiar në vend, pasuar nga sektori pensional (figura 2).

Figura 2. Asetet e sektorëve përbërës të sistemit financiar në tremujorët përkatës



Burimi: BQK (2019)

Zgjerimi i aktivitetit kreditor të sektorit bankar u mbështet kryesisht nga rritja e depozitave, ndërsa

aktiviteti i sektorit pensional u mbështet prej kthimit të kënaqshëm nga investimet.

## Sektori Bankar

Sektori bankar gjatë këtij tremujori u karakterizua me rritje të lartë të aktivitetit kreditor, i ndikuar pozitivisht si nga oferta më e lehtësuar kreditore ashtu edhe nga kërkesa për kredi. Pozita financuese e aktivitetit kreditor u përforcua, kryesisht përmes përmirësimit të kushteve të ofruara nga bankat për depozitat. Sektori vazhdoi të jetë mirë i kapitalizuar dhe likuid, me fitim neto lehtësisht më të lartë se ai i realizuar gjatë tremujorit të njëjtë të vitit paraprak.

## Asetet


Në TM2 2019, asetet e sektorit bankar u rritën për 74.3 milionë euro duke kontribuar në vlerën e stokut të asetëve prej 4.30 miliardë euro në fund të periudhës. Rritja e përgjithshme e asetëve të sektorit bankar i atribuohet dinamikave pozitive të kreditimit, aktivitet që u mbështet si nga kërkesa e rritur për kredi, ashtu edhe nga oferta e lehtësuar e bankave përmes ofrimit të kushteve më të mira për kredidhënie (figura 3).

Kategoria e parasë së gatshme të mbajtur në trezor të bankave është rritur për 6.0 milionë euro në këtë tremujor, ndërsa bilanci me BQK-në (rezervat e bankave të mbajtura në BQK) u zvogëluar për 4.8 milionë euro.

Bilanci me bankat tjera u zvogëluar për 29.8 milionë euro krahas rënies prej 33.0 milionë euro në TM2 2018,

ku stoku i tyre zbriti në vlerën prej 284.5 milionë euro në fund të periudhës.

Figura 3. Struktura e aseteve të sektorit bankar në tre mujorët përkatës




Në fund të periudhës raportuese, stoku i letrave me vlerë të sektorit bankar arriti në vlerë prej 419.7 milionë euro, duke u zvogëluar për 16.5 milionë euro vetëm gjatë TM2 2019. Përderisa investimet në letra me vlerë të qeverive të huaja u zvogëluan për 16.5 milionë euro, investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës kishin efekt neutral në rritje.

### Kreditë


Aktiviteti kreditues vijoi të karakterizohet me rritje edhe gjatë TM2 2019. Në fund të periudhës së cekur, stoku i kredive arriti vlerën prej 2.94 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 10.5 përqind. Vetëm gjatë TM2 2019, kreditë u rritën për 115.9 milionë euro, krahasuar me rritjen për 127.0 milionë euro në TM2 2018 (figura 3).

Figura 4. Ndryshimi vjetor i tremujorëve përkatës të kredive dhe kategorive kryesore të kredive



Ndikim pozitiv në rritjen e kredive aktive gjatë TM2 2019 kishin kreditë e reja të lëshuara për të dy kategoritë: ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare (figura 5). Oferta e lehtësuar bankare, shprehur përmes përmirësimit të kushteve të kreditimit, dhe rritja e kërkesës për kredi nga të dy kategoritë, rezultoi në rritje të përgjithshme të aktivitetit kreditues.

Figura 5. Kredite aktive dhe të reja per ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare




Kreditë për ndërmarrje<sup>1</sup> janë rritur për 72.5 milionë euro gjatë tremujorit të dytë, duke arritur vlerën prej 1.87 miliardë euro (figura 4). Në baza vjetore, kreditimi ndaj të gjithë sektorëve ekonomik u karakterizua me zgjerim të përshpejtuar në periudhën raportuese, me

<sup>1</sup> Përfshinë vetëm kreditë e korporatave jofinanciare

përjashtim të kreditimit ndaj sektorit të tregtisë i cili u karakterizua me ngadalësim të rritjes.

Figura 6. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike



Vetëm gjatë tremujorit të dytë, kreditimi ndaj sektorit të prodhimit u zgjerua për 10 milionë euro, të ndërtimitarisë për 13.1 milionë euro, ndërsa ndaj sektorit të tregtisë 19.1 milionë euro (gjatë tremujorit të njëjtë të vitit paraprak rritja ishte për 53.7 milionë euro) (figura 6). Me gjithë ndikimin e sezonalitetit dhe dinamikave me të cilët karakterizohen sektor të ndryshëm ekonomik në periudha të ndryshme, sektorët e lartpërmendur kishin rritje më të lartë edhe krahas tremujorit paraprak (përjashtuar prodhimtarinë).

Kreditë e reja për ndërmarrje arritën vlerën në 240.6 milionë euro gjatë TM2 2019, prej të cilave 139.8 milionë euro ishin kredi të destinuar për investime, kurse 97.6 milionë euro për qëllime jo-investive. Sa i përket sektorëve ekonomik, kreditë e reja për sektorin e bujqësisë arritën vlerën prej 5.3 milionë euro, një rritje prej 2.2 milionë euro kundrejt TM2 2018. Po ashtu, rritje shënuan edhe kreditë e reja të destinuar për industrinë të cilat ishin për 9.4 milionë euro më të larta se në tremujorin e njëjtë të vitit paraprak dhe ku vlera e tyre gjatë TM2 2019 arriti në 85.9 milionë euro.


Ndryshe, kreditë e reja për sektorin e shërbimeve u zvogëluan për 5.9 milionë euro, duke rënë në vlerën prej 130.2 milionë euro.

Kreditë ndaj ekonomive familjare në TM2 2019 u shtuan për 42.9 milionë euro, duke arritur vlerën e stokut prej 1.06 miliardë euro në fund të periudhës (figura 4). Sa i përket kredive të reja për ekonomitë familjare, në këtë tremujor është evidentuar rënie tremujore për 4.3 milionë euro, gjë që u përkatte edhe në vlerën e përgjithshme të shënuar në TM2 2019 prej 160.7 milionë euro (165.0 milionë euro në TM2 2018). Kjo rënie u reflektua më shumë tek kreditë e reja konsumuese, të cilat u zvogëluan për 6.3 milionë kundrejt tremujorit të njëjtë të vitit paraprak. Njëkohësisht, kreditë e reja hipotekare të lëshuara arritën vlerën prej 27.6 milionë euro, apo 0.7 milionë euro më e lartë krahasuar me TM2 2018.

### Detyrimet dhe burimet vetanake

Struktura e detyrimeve të sektorit bankar dominohet nga depozitat, të cilat përbëjnë 80 përqind të gjithsej detyrimeve dhe burimeve vetanake. Në këtë tremujor,

Figura 7. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake



rritja e nivelit të depozitave për 41.6 milionë euro rezultoi të jetë zhvillim pozitiv krahasuar me rritjen



prej 11.9 milionë euro në TM2 2018 (figura 7). Stoku i depozitave arriti vlerën prej 3.43 miliardë euro në fund të TM2 2019.

Kategoria e burimeve vetanake u karakterizua me rënie prej 11.8 milionë euro në TM2 2019 (3.2 milionë euro rënie gjatë TM2 2018) dhe stoku i tyre arriti në 506.2 milionë euro, që kryesisht reflekton ndarjen e dividendave gjatë këtij tremujori .

Ndërsa, kategoria e bilancit nga bankat tjera shënoi rritje për 17.4 milionë euro (22.9 milionë euro gjatë TM2 2018), dinamikë që kryesisht reflekton rritjen e huazimeve apo linjave të ndryshme kreditore nga bankat jashtë vendit, përkatësisht bankat amë. Në fund të TM2 2019, stoku i bilancit me bankat komerciale arriti në vlerën prej 87.0 milionë euro (98.9 milionë euro në TM2 2018).


### Depozitat

Zhvillimet në kuadër të depozitave të sektorit bankar në TM2 2019 i atribuohen kryesisht ecurisë pozitive të depozitave të ekonomive familjare, përderisa ecuritë në depozitat e ndërmarrjeve kontribuuan në një ritëm më të ulët të rritjes. Depozitat e ndërmarrjeve<sup>2</sup> u zgjeruan për 16.0 milionë euro në këtë tremujor, duke ndikuar që stoku i tyre të rritet në vlerë prej 596.8 milionë euro në fund të periudhës raportuese (figura 8).

Kjo dinamikë reflekton rritjen e depozitave të afatizuara të ekonomive familjare, që ndërlidhet me rritjen e normës së interesit në depozita të afatizuara. Depozitat për ekonomitë familjare u rritën për 24.0 milionë euro në këtë tremujor, dhe stoku i depozitave

të ekonomive familjare arriti vlerën prej 2.42 miliardë euro në fund të periudhës së cekur (figura 8).


Figura 8. Vlera e gjithsej depozitave dhe kategorive kryesore gjatë TM2



Burimi: BQK (2019)

Sipas kategorive të depozitave, depozitat e transferueshme u rritën për 3.6 milionë euro në TM2 2019, dhe stoku i tyre zbriti në vlerë prej 2.01 miliardë euro në fund të periudhës. Ndërsa, depozitat e afatizuara u rritën për 33.2 milionë euro (stoku i tyre arriti vlerën prej 920.7 milionë euro). Poashtu, edhe depozitat e kursimit u rritën për 4.9 milionë euro, duke arritur stokun në vlerë prej 490.3 milionë euro (figura 9).

Figura 9. Struktura e depozitave gjatë periudhave raportuese



Burimi: BQK (2019)


<sup>2</sup> Përfshinë vetëm depozitat e korporatave jofinanciare

Për dallim nga periudhat paraprake, kushtet më të volitshme të ofruara nga ana e bankave kundrejt kthimit nga depozitat u përkthyen në ndryshime pozitive në strukturën e depozitave të sektorit bankar. Zgjerimi i pjesëmarrjes së depozitave të afatizuara në gjithsej depozitat e sektorit kundrejt tkurrjes së depozitave të transferueshme (megjithëse në masë të ulët), mund të ndikoj pozitivisht në reduktim të rrezikut që mund të vie nga mospërputhjet e maturitetit në mes të aseteve dhe detyrimeve.

### Normat e Interesit<sup>3</sup>

Në TM2 2019, niveli i normës së interesit në kredi u zvogëluar për 0.2 pikë përqindje nga viti paraprak, përderisa norma e interesit në depozita u rrit për 0.1 pikë përqindje. Rrjedhimisht, margjina në mes të normës të interesit në kredi dhe asaj në depozita u zvogëluar në 5.1 pikë përqindje në periudhën raportuese (5.4 pikë përqindje në TM2 2018) (figura 10).

Figura 10. Norma e interesit në kredi dhe depozita




Burimi: BQK (2019)

### Normat e interesit në kredi

Gjatë tremujorit të dytë, norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve qëndroi në nivel të njëjtë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, më konkretisht në mesataren prej 6.3 përqind (figura 11). Kategoria e kredive për qëllime investive dhe kredive me kushte favorizuese patën normë më të ulët të interesit krahas periudhës së njëjtë të vitit paraprak, 6.24 përqind, dhe 2.83 përqind përkatësisht. Përderisa, normat e interesit për kreditë jo-investive u rritën në 6.44 përqind.

Figura 11. Normat e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve



Burimi: BQK (2019)


Normat e interesit në kreditë për sektorin e bujqësisë dhe të industrisë u rritën në mesataren tremujore prej 7.6 përqind dhe 6.3 përqind, përkatësisht. Ndërkaq, kreditë për sektorin e shërbimeve dhe sektorët tjerë kishin normë të pandryshuar të interesit prej 6.4 përkatësisht 6.0 përqind (figura 11).

Normat e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare kanë vazhduar trendin rënës edhe në TM2 2019. Normat e interesit të aplikuara për kreditë hipotekare vazhdojnë të jenë më të favorshme duke qëndruar mesatarisht në nivelin prej 5.7 përqind, kurse për

<sup>3</sup> Kalkulimi i normave të interesit: mesatarja tremujore e normave të interesit në kredi, gjegjësisht në depozita. Në tekst ju referohemi si 'normë e interesit'.

kreditë konsumuese u zvogëluan në mesatarisht 6.7 përqind (figura 12).

Figura 12. Normat e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare




Burimi: BQK (2019)

### Normat e interesit në depozita

Normat e interesit në depozita vazhduan trendin rritës të vitit paraprak. Norma mesatare e interesit në depozita prej 1.4 përqind gjatë TM2 2019 rezultoi të jetë për 0.1 pikë përqindje më e lartë se në TM2 2018 (figura 13).

Figura 13. Norma e interesit në depozita




Burimi: BQK (2019)

Normat e interesit në depozitat për ndërmarrjet vazhdojnë të jenë më të larta krahasuar me normat që ofrohen për ekonomitë familjare. Në depozitat e ndërmarrjeve, norma e interesit qëndroi në nivel

pothuajse të njëjtë prej 1.6 përqind kundrejtë periudhës së njëjtë të vitit paraprak, me rënie të lehtë prej 0.05 pikë përqindje.


Figura 14. Norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve, sipas kategorive



Burimi: BQK (2019)

Kjo rënie pasqyron rënien e normës së interesit në depozitat të transferueshme e cila ishte 0.0 përqind nga 0.1 përqind, dhe rritjen e lehtë në depozitat e afatizuara për 0.05 pikë përqindje. (figura 14).

Figura 15. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare, sipas kategorive



Burimi: BQK (2019)

Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare u rrit për 0.2 pikë përqindje dhe arriti në 1.3 përqind (figura 15). Kjo rritje pasqyron rritjen e normës së interesit në depozitat e afatizuara, të cilat arritën në 1.3 përqind dhe të kursimit që arritën në 0.4 përqind. Norma e interesit në depozitat e transferueshme ishte

e ngjashme me periudhën paraprake në nivelin mesatar tremujor prej 0.001 përqind. Rritja e normës së interesit në depozita përbën nxitje për ekonominë për alokimin e mjeteve të tyre drejt instrumenteve me afat më të gjatë maturimi, duke krijuar njëkohësisht financim më stabil për sektorin bankar.

### Performanca e sektorit bankar

Vlera e profitit të realizuar gjatë TM2 2019 rezultoi të jetë për 0.4 milionë euro më e lartë krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, duke arritur në 21.2 milionë euro. Profiti më i lartë i realizuar vetëm gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019 krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak i'u atribuua kryesisht rritjes më të lartë të të hyrave nga interesi në kredi.


Megjithatë, për periudhën gjashtëmujore të këtij viti, profiti rezulton të jetë për 0.2 milionë euro më i ulët krahasuar me vitin paraprak, që kryesisht i atribuohet rritjes më të lartë të shpenzimeve të sektorit përkundër rritjes së të hyrave (figura 16).

Të hyrat e sektorit bankar u karakterizuan me rritje vjetore prej 8.8 përqind, kryesisht si rezultat i performancës në të hyrat nga interesi (kryesisht nga kreditë dhe letrat me vlerë), por edhe rritjes së të ardhurave nga tarifat dhe komisionet në kuadër të të hyrave nga jointerеси (figura 16).

Në anën tjetër, vlera e shpenzimeve të sektorit bankar në TM2 2019 shënoi rritje prej 15.9 përqind krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak (figura 16). Rritja e shpenzimeve të sektorit bankar kryesisht i atribuohet rritjes së shpenzimeve të jo interesit, më konkretisht rritjes së shpenzimeve nga nënkategoria e

provizioneve për mbulim të humbjeve të mundshme nga kreditë, të cilat u rritën për 5.9 milionë euro nga 3.2 milionë euro gjatë TM2 2018. Ndërsa në kuadër të shpenzimeve për interesa, rritje shënuan kryesisht shpenzimet për interesa të depozitave të afatizuara si pasojë e rritjes së kostos së financimit të tyre. Në anën tjetër, kategoria e shpenzimeve administrative dhe të përgjithshme u rrit lehtësisht për 26.5 milionë euro, krahasuar me periudhën gjatë TM2 2018 që shënoi rritje për 24.1 milionë euro.

Figura 16. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar




Burimi: BQK (2019)

Si rezultat i rritjes më të lartë të shpenzimeve, raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave në TM2 2019 u rrit në 67.2 përqind, që nënkupton se për çdo 1 euro të arkëtuar sektori bankar shpenzon 0.672 euro, vlerë kjo më e lartë për 4.1 pikë përqindje. Rrjedhimisht, pozicioni financiar i sektorit bankar në TM2 2019 u reflektua negativisht edhe në dy indikatorët e profitabilitetit, kthimin në mesataren e aseteve (KMA) edhe kthimin në mesataren e kapitalit (KMK). Saktësisht, KMA u zvogëluar për 0.3 pikë përqindje në 2.0 përqind, ndërsa KMK u zvogëluar për 1.2 pikë përqindje në 17.5 përqind (figura 16).

### Treguesit e shëndetit financiar

Sektori bankar vazhdon të karakterizohet me përmirësim të cilësisë së portfolios kreditore, bazuar në rënien e mëtutjeshme të nivelit të kredive joperformuese dhe rritjes më të lartë të mbulueshmërisë së tyre me provizione.


Figura 17. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve



Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur  
Burimi: BQK (2019)

Niveli i kredive joperformuese në fund të TM2 2019 zbriti në 2.5 përqind, që paraqet një rënie prej 0.3 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 17).

Figura 18. Treguesi i solvencës




Burimi: BQK (2019)

Rënia e nivelit të kredive joperformuese dhe i rritjes së provizioneve deri në fund të tremujorit të parë ndikoi

që raporti prej 161.2 përqind i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione të jetë për 5.6 pikë përqindje më i lartë së në fund të tremujorit të dytë të vitit të kaluar.

Pozita e kapitalit të sektorit vazhdon të reflektoj qëndrueshmëri të lartë. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në fund të TM2 2019 qëndroi në nivel prej 16.8 përqind, nga 17.4 përqind në TM2 2018. Rritja e kreditimit gjatë këtij viti ka ndikuar në rritjen e ekspozimit të sektorit ndaj aseteve me peshë rreziku. Për pasojë, përkundër rritjes prej 6.5 përqind të kapitalit rregullator, efekti më i lartë i rritjes së aseteve me peshë rreziku prej 9.8 përqind kundrejt rritjes së kapitalit rregullator, është reflektuar në rënien e treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit për 0.5 pikë përqindje. Pavarësisht rënies, sektori bankar ka bazë të fortë të kapitalit rregullator, 88.4 përqind e të cilit është kapital i klasit të parë. Ky kapital kryesisht rezulton nga profiti i realizuar dhe ai i mbajtur, e që nënkupton se bankat janë të orientuara në krijimin e kapitalit kryesisht brenda aktivitetit të tyre duke mbajtur fitimin në formë të ekuitetit (figura 18).

Figura 19. Treguesit e likuiditetit



Burimi: BQK (2019)

Treguesi kyç i likuiditetit, raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra qëndroi në 35.1 përqind, një rritje prej 1.9 pikë përqindje kundrejt TM2 2018. Rritja më e lartë e mjeteve likuide, më konkretisht bilancit me BQK-në dhe depozitave e plasmaneve në banka të tjera, u reflektua në rritjen e këtij indikatorit. Raporti i kredive ndaj depozitave qëndroi në nivel prej 85.8 përqind, që është më i ulët edhe me tendencë rënëse, kryesisht si pasojë e rritjes më të shpejtë të depozitave krahas rritjes së kreditimit (figura 19).


### **Sektori pensional**

*Sektori pensional u karakterizua me rritje të aseteve, rritje që kryesisht i atribuohet kthimit pozitiv nga investimet dhe kontributeve të arkëtuara gjatë kësaj periudhe.*

Sektori pensional është sektori i dytë për nga pesha e rëndësisë në sistemin financiar, që përbën 28.1 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar në vend. Deri në fund të TM2 2019, vlera e stokut të aseteve të menaxhuara nga fondet pensionale arriti në 1.87 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 10.6 përqind.

Në TM2 2019, asetet e sektorit u zgjeruan për 51.9 milionë euro, që është si rrjedhojë e kontributeve të arkëtuara dhe kthimit nga investimet gjatë kësaj periudhe (figura 20).


Figura 20. Asetet e sektorit pensional, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK (2019)

FKPK, e cila përbënë 99.6 përqind të aseteve të sektorit, pjesën më të madhe të mjeteve i ka të investuara në sektorin e jashtëm (figura 21).

Figura 21. Struktura e aseteve të FKPK-së (TM2 2019)




Burimi: FKPK (2019)

Në këtë tremujor, FKPK shënoi kthim pozitiv në investime në vlerë prej 19.5 milionë euro (figura 23). Kjo rritje erdhi kryesisht si rezultat i performancës së investimeve në tregjet e jashtme (+17.8 milionë euro), ndikuar nga përmirësimi i treguesve kryesor ekonomik në tregjet globale dhe deri në një masë, nga zbutja e tensioneve të 'luftës tregtare' SHBA – Kinë. Investimet brenda vendit në TM2 2019 poashtu realizuan performancë pozitive (+ 1.8 milionë euro). Për më tepër, gjatë këtij tremujori, investimet në letrat me vlerë të

Qeverisë së Kosovës u shtuan për 10.4 milionë euro kurse në certifikatat e depozitit (sektorin bankar) për 25.6 milionë euro. Investimet e aseteve të FSKP janë të shpërndara kryesisht në aksione jashtë vendit, pasuar nga obligacionet e Qeverisë së Kosovës dhe të qeverive të huaja (figura 22). FSKP realizoi kthim pozitiv bruto nga investimet prej 142.7 mijë euro (- 53.9 mijë euro në TM2 2018).


Figura 22. Struktura e aseteve të FSKP-së (TM2 2019)



Burimi: FSKP (2019)

Arkëtime të reja të sektorit pensional gjatë TM2 2019 arritën vlerën prej 46.3 milionë euro, që paraqet rritje prej 7.9 përqind në krahasim me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak (figura 23). Në kontributet e arkëtuara, 99.7 përqind i përkasin FKPK-së.

Figura 23. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së




Burimi: FKPK (2019)

## Sektori i sigurimeve

*Sektori i sigurimeve shënoi rritje të aktivitetit. Megjithatë, përkundër rritjes së primeve të shkruara, sektori i sigurimeve u karakterizua me rezultate negative financiare si pasojë e rritjes së shpenzimeve operative dhe kompensimeve për dëmet e paguara.* Asetet e sektorit të sigurimeve shënuan rritje për 9.0 milionë euro në TM2 2019 (figura 24), ndërsa vlera e stokut të aseteve të sektorit deri në fund të qershorit arriti në 190.0 milionë euro (rritje vjetore prej 8.7 përqind).

Rritja e aktivitetit të sektorit në këtë tremujor kryesisht i'u atribua rritjes së aseteve likuide (+ 2.6 milionë euro), të hyrave të arkëtueshme nga siguruesit (+2.3 milion euro) dhe rritjes së investimeve në letrat me vlerë për 1.3 milionë euro.

Figura 24. Asetet e sektorit të sigurimeve, ndryshimi tremujor




Burimi: BQK (2019)

Në kuadër të detyrimeve dhe mjeteve vetanake të sektorit, ekuiteti i sektorit mbeti pothuajse i ngjashëm me periudhën paraprake, në 45.3 milionë euro në fund të TM2 2019. Kjo, kryesisht si pasojë e operimit me humbje të sektorit të sigurimeve, pavarësisht rritjes së kapitalit aksionar (+1.7 milionë euro) gjatë këtij tremujori. Në TM2 2019, në kuadër të detyrimeve të sektorit, rritje më të theksuar shënuan kategoria e

rezervave teknike (+ 7.1 milionë euro) dhe kategoria e llogarive tjera të pagueshme (+ 1.7 milionë euro). Rritja e këtyre dy kategorive, ndër tjerash, siguron mbarëvajtjen e shlyerjes së obligimeve ndaj mbajtësve të polisave të sigurimit.

Vlera e primeve të shkruara nga kompanitë e sigurimeve gjatë TM2 2019 arriti në 25.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 10.4 përqind. Kontributin më të lartë në rritjen e gjithsej primeve e kishte kategoria e primeve ‘jo përgjegjësitë ndaj palës së tretë’, si në numër të polisave të shitura dhe vlerë të primit të shitur. Primet e sigurimit jo-jetë përfaqësojnë 96.4 përqind të gjithsej strukturës së primeve të shkruara, vlera e të cilave arriti në 24.6 milionë euro (rritje vjetore prej 10.3 përqind). Ndërsa, vlera e primeve të shkruara nga sigurimi ‘jetë’ u karakterizua me rritje vjetore prej 14.9 përqind duke arritur vlerën në 908.8 mijë euro.

Figura 25. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve (përfshirë dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit) u rritën për 0.8 milionë euro në këtë tremujor krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, dhe arritën vlerën prej 12.5 milionë euro (11.7 milionë euro në TM2

2018). Rritja më e lartë e primeve të shkruara krahasuar me rritjen e dëmeve të paguara, ndikoi në përmirësimin e lehtë të raportit dëme/prime, që zbriti në 49.0 përqind nga 50.6 përqind sa ishte në tremujorin e dytë të vitit paraprak (figura 25).

### Performanca e sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve në TM2 2019 shënoi humbje prej 2.6 milionë euro kundrejt profitit prej 0.34 milionë euro në TM2 2018, përkundër rritjes së nivelit të primeve të shkruara, kryesisht si pasojë e rritjes së shpenzimeve operative dhe kompensimeve për dëmet e ndodhura.

Likuiditeti i sektorit të sigurimeve shënoi rënie deri në qershor 2019 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rritja më e ngadalësuar vjetore e parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj (3.4 përqind) krahasuar me rritjen e rezervave teknike (10.6 përqind) rezultoi që raporti në mes tyre të zbret në 90.6 përqind nga 97.0 përqind në qershor 2018. Treguesi tjetër i likuiditetit, raporti i parasë së gatshme e ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve u zvogëlua në 80.1 përqind, nga 86.5 përqind sa ishte në qershor të vitit të kaluar, si pasojë e rritjes së detyrimeve prej 11.6 përqind.

### Sektori mikrofinanciar


*Sektori mikrofinanciar ka treguar shenja të ngadalësimit të aktivitetit megjithë rritjen e shënuar. Në TM2 2019, sektori u karakterizua me ngadalësim të rritjes së aktivitetit kreditues, ulje të profitit të realizuar, dhe rritje të kredive me probleme.*



## Asetet

Gjithsej asetet e sektorit mikrofinanciar u rritën për 17.2 milionë euro gjatë TM2 2019, duke kontribuar në vlerën e gjithsej stokut të aseteve prej 285.1 milionë euro në fund të qershorit 2019 (figura 26). Rritja e aktivitetit kreditues dhe lizingjeve kishin kontributin kryesor në zgjerimin e aseteve të sektorit gjatë TM2 2019.

Figura 26. Asetet e sektorit mikrofinanciar, ndryshimi tremujor




Burimi: FKPK (2019)

Sektori mikrofinanciar kryesisht financon aktivitetin përmes linjave kreditore nga institucionet tjera financiare, që në TM2 2019 arritën vlerën në 14.2 milionë euro (10.0 milionë euro janë kredi të marra nga sektori i jashtëm).

## Kreditë

Kreditë në TM2 2019 u rritën për 10.8 milionë euro, që paraqet një zvogëlim për 2.2 milionë euro krahasuar me TM2 2018 (figura 27).


Figura 27. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK (2019)

Kreditë për ekonomitë familjare kishin kontributin kryesor në zgjerimin e gjithsej kreditimit në TM2 2019, edhe pse shënuan rritje më të ngadalësuar.

Figura 28. Vlera e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve të ekonomisë, ndryshimi tremujor




Burimi: BQK (2019)

Ngjashëm, edhe kreditimi ndaj ndërmarrjeve u karakterizua me rritje më të ngadalësuar. Kjo u reflektua edhe në sektorët që kanë peshën më të madhe në gjithsej kreditë për ndërmarrje siç janë kreditë për sektorin e industrisë, ndërtimtarisë dhe tregtisë (figura 28).

**Lizingjet**

Figura 29. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar, ndryshimi tremujor




Burimi: BQK (2019)

Aktiviteti i lizingjeve gjatë TM2 2019 u rrit për 4.9 milionë euro, që paraqet një rritje prej 0.3 milionë euro krahasuar me TM2 2018, duke rritur kështu stokun e lizingjeve në 45.2 milionë euro në fund të qershorit 2019 (figura 29). Lizingu për ndërmarrje shënoi rritje më të theksuar krahasuar me TM2 2018, kurse lizingu për ekonomitë familjare shënoi ngadalësim të rritjes.

**Normat e Interesit**

Figura 30. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2019)

Norma mesatare e interesit në kredi në tremujorin e parë të vitit 2019 u zvogëlua në 20.3 përqind, nga 23.2 përqind sa ishte në TM2 2018. Me rënie më të theksuar u karakterizuan normat në kredi për ekonomitë

familjare (për 4.0 pikë përqindje), kurse ato për ndërmarrje u zvogëluan për 2.3 pikë përqindje (figura 30).

Figura 31. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: BQK (2019)


Në kuadër të ekonomive familjare, norma mesatare e interesit për kreditë konsumuese në TM2 2019 ishte 20.7 përqind, kurse për kreditë hipotekare, norma e interesit rezultoi të jetë 21.9 përqind.

Në kuadër të ndërmarrjeve, sektori i shërbimeve vijon të ketë normën më të ulët të interesit në kredi, ndërsa, sektori i industrisë mbetet sektori me normën më të lartë të interesit në kredi (figura 31).

**Performanca e sektorit mikrofinanciar**

Gjatë TM2 2019, rritja më e lartë e shpenzimeve të sektorit mikrofinanciar kundrejt rritjes së të hyrave u reflektua në uljen e profitit të realizuar gjatë këtij tremujori për 0.5 milionë euro krahasuar me TM2 2018 dhe zvogëlimin e vlerës së tij në 2.3 milionë euro (figura 32 dhe 33).

Figura 32. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar në TM2




Burimi: BQK (2019)

Të hyrat nga interesi në TM2 2019 arritën vlerën prej 13.5 milionë euro (9.2 milionë euro në TM2 2018), duke reflektuar nivelin e lartë të aktivitetit kreditues nga ky sektor në prani të normave të larta të interesit (20.3 përqind mesatarja në TM2 2019).

Rritja e shpenzimeve të personelit dhe ndarja më e lartë e provizioneve për humbjet e mundshme nga kreditë kishin kontributin kryesor në rritjen e gjithsej shpenzimeve të sektorit mikrofinanciar.

Figura 33. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar në TM2




\*Profiti është analizuar për tremujorin përkatës  
Burimi: BQK (2019)

Kreditë me probleme shënuan rritje, megjithëse raporti i tyre ndaj gjithsej kredive qëndron në nivel të ulët dhe janë mirë të mbuluara me provizione (figura 34). Niveli i kredive joperformuese në qershor 2019

ishite 3.4 përqind (2.5 përqind në qershor 2018). Kurse, mbulueshmëria e tyre me provizione në qershor 2019 arriti në 184.0 përqind (202.2 përqind në qershor 2018).

Figura 34. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore




Burimi: BQK (2019)

## Tregu i letrave me vlerë

Në TM2 2019, Qeveria e Kosovës emetoi borxh në vlerë prej 110 milionë euro, në një ambient ku ofertat nga institucionet financiare tejkaluan shumën e kërkuar nga Ministria e Financave.


Figura 35. Shuma e borxhit të emetuar, rritja vjetore



Burimi: Ministria e Financave

Gjatë TM2 2019, Qeveria e Kosovës emetoi letra me vlerë në shumën prej 110.0 milionë euro (114.4 milionë euro në TM2 2018), që përbën një rënie vjetore prej 3.9 përqind (figura 35).


Figura 36. Shuma e ofruar dhe emetuar



Burimi: Ministria e Financave (2019)

Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë ishte 1.54 në TM2 2019, për 0.2 pikë përqindje më e lartë se në TM2 2018 (figura 36).

Figura 37. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave (2019)

Struktura e letrave me vlerë dominohet nga fletë-obligacionet qeveritare, të cilat përbëjnë rreth 73.0 përqind (prijnë ato me maturitetet prej 3 vite) të gjithsej letrave me vlerë dhe pjesa e mbetur përbëhet nga bonot e thesarit (figura 37).

### **Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:**

BQK (2019): Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiar Nr. 27, TM2 2019, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

### **Referencat:**

BQK (2019):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <https://bqk-kos.org/?id=55>

ASK (2019):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-)
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-)
- c) Indeksi i çmimeve të importit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-)
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>
- f) Buletini Tremujor

### **Të tjera (2019):**

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandëve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-qov.net/page.aspx?id=1,46>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditore: <http://www.fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës; Raporte tremujore: <http://www.trusti.org/sq/per-ne/raporte/835-2/>

Bloomberg (2018): Metal Prices database.

FAO (2018): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations:  
<http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2019): Euribor Historical Rates:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2019): World Economic Outlook:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2016/02/weodata/index.aspx>



## Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Qershor 2018	Qershor 2019
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)	1,298.8	1,378.7
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	0.3%	3.2%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	0.8%	2.9%
Sektori fiskal* 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	792.3	853.5
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	829.4	853.2
Bilanci primar (në milionë euro)	-37.1	0.3
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	5,995.4	6,666.4
prej të cilave: Bankat	3,891.5	4,303.4
Kredi	2,661.3	2,940.0
Depozita	3,085.9	3,425.3
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	6.5%	6.3%
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	1.2%	1.3%
Hendeku i normës së interesit	5.3%	5.1%
Sektori i jashtëm*, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-433.8	-388.4
prej të cilave: remitencat e pranuar	384.5	405.6
Llogaria financiare	-200.1	-160.0
Investimet e huaj direkte në Kosovë	79.9	122.5
Investimet portfolio, net	59.9	-31.7
Investimet tjera, net	-214.5	-265.3
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net*	-135.4	-345.6
Asetet	4,776.0	4,884.9
Detyrimet	4,911.4	5,230.6
Borxhi i jashtëm, gjithsej*	2,004.3	2,037.9
Borxhi i jashtëm privat	1,511.6	1,540.7
Borxhi i jashtëm publik	492.7	497.3

Burimi:

1/ ASK (2019), BPV është vetëm për TM1 sepse për TM2 2019 nuk është publikuar ende.

2/ MF (2019).

3/ BQK (2019).

\*Të dhënat për bilancin e pagesave janë deri në qershor 2019 ndërsa për PNI dhe borxh të jashtëm deri në mars 2018.

